L I G J
Nr. 8708, datë 1.12.2000

PËR DISA PËRJASHTIME DHE PËR DHËNIEN E DISA STIMUJVE PËR NDËRTIMIN E HIDROCENTRALIT TË KALIVAÇIT ME KONCENSION TË FORMËS "BOT"

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Neni 1

Periudha e koncensionit në marrëveshjen e koncensionit të formës "BOT" të Hidrocentralit të Kalivaçit, është 30 vjet nga data e fillimit të punimeve të ndërtimit.

Neni 2

Asnjë akt ligjor, i dalë pas hyrjes në fuqi të marrëveshjes së koncensionit, nuk mund të cenojë këtë marrëveshje.

Neni 3

Shoqëria koncensionare e Hidrocentralit të Kalivaçit, sipas nenit 31 të ligjit nr.7928, datë 27.4.1995 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar", taksohet me vlerë të TVSH-së në masën zero për qind për mallrat dhe shërbimet e eksportit, gjatë gjithë periudhës së koncensionit.

Organet tatimore bëjnë rimbursimin e tepricës kreditore të TVSH-së brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës.

Neni 4

Shoqëria koncensionare e Hidrocentralit të Kalivaçit përjashtohet nga detyrimet e importit dhe çdo lloj takse, që ka të bëjë me importin dhe eksportin e mallrave dhe shërbimeve, si për periudhën e ndërtimit edhe për periudhën e koncensionit.

Neni 5

Shoqëria koncensionare e Hidrocentralit të Kalivaçit përjashtohet nga detyrimi i tatimit mbi fitimin për dy vitet e para të shfrytëzimit dhe, për periudhën tjetër të koncensionit, detyrimi i tatimit mbi fitimin të jetë në masën 15 për qind.

Neni 6

Në rastet e shpronësimit ose konfiskimit të impiantit, nga autoritetet shqiptare do të zbatohen dispozitat ligjore shqiptare në fuqi.

Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2845, datë 23.12.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani